

POTENCIALI I PASHFRYTËZUAR I QEVERISJES VENDORE

Rasti studimor Dibër e Ura Vajgurore



Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsielltë të ideve të reja.

Përgatiti:

Besfort Lamallari,
Brikena Hoxha,
Eda Lika,
Indrit Puteci,
Manushaqe Rina,
Juliana Memaj

Problematika dhe Perspektiva

Në dhjetor 2015, u miratua ligji i ri për qeverisjen vendore. Ligji u përshëndet si një instrument i cili parashikonte shtatëmbëdhjetë funksione të reja për njësitë e qeverisjes vendore, në një total nga pesëdhjetë e gjashtë të tilla.¹ Gjithashtu, një strategji e re decentralizimi 2015-2020 u miratua në korrik 2015, megjithëse mbetet ende punë për tu bërë në drejtim të procesit të decentralizimit.² Reforma territoriale administrative ka si objektivi që të adresojë problematikat e mbartura për një kohë të gjatë të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore duke synuar që të nxisë fuqizimin e 61 bashkive të ri-organizuara përmes nxitjes së kapaciteteve të tyre për ofrimin e shërbimeve më cilësore si dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve të tyre.

Megjithatë, në praktikë qeverisja vendore në Shqipëri paraqet ende problematika të ndryshme, të evidentuara vazhdimisht nga raporte të brendshme dhe të huaja. Kështu, sipas vlerësimit më të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, megjithëse një fond prej 13.2 milion Euro u akordua për zbatimin e reformës territoriale administrative, njësitë e qeverisjes vendore shfaqin ende nevojën për forcimin e sistemeve të tyre të menaxhimit financiar. Për më tepër, raporti vlerëson se shpenzimet për qeverisjen vendore u rritën në 2.3 përqind në buxhetin e vitit 2014, por ato mbeten sërish nën nivelin e synuar. Gjithashtu, ky dokument sugjeron që strategjia e decentralizimit të trajtohet në përputhje me programin buxhetor afat-mesëm 2016-2018. Së fundmi, raporti thekson nevojën e forcimit të kapaciteteve të 61 njësive të reja, me qëllim hartimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit vendor si dhe ofrimin e shërbimeve, përfshirë ato “one-stop-shop”. Për trajnimin dhe forcimin e

¹ “Approved Draft Law “On Local Self-Government,”” Reforma Administrative Territoriale, 17 December 2015, <http://www.reformateritoriale.al/en/home/12-news-information/265-approved-draft-law-on-local-self-government>

² Lamallari, B., Freedom House, Nations in Transit 2016: Albania, fq.8
https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2016%20Albania_1.pdf

kapaciteteve, nevojitet një strategji gjithpërfshirëse mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.³

Duke marrë në konsideratë tablonë e paraqitur më sipër, ky studim synon që përmes analizimit të situatës aktuale të qeverisjes vendore të ofrojë një set rekomandimesh me qëllim fuqizimin e njësisive të reja vendore, veçanërisht në aspektin e potencialit të tyre financiar. Megjithëse qeverisja vendore nuk paraqet një rol specifik në kuadër të procesit të integritit të vendit, bashkitë kanë gjithsesi një rol të rëndësishëm për të luajtur në drejtim të zbatimit të legjislacionit të përafuar dhe përmbushjes së standardeve evropiane. Për më tepër, njësitë e qeverisjes vendore mund të përfitojnë mbështetjeje financiare, por jo vetëm, nga Bashkimi Evropian, shtete anëtare apo institucioneve ndërkombëtare. Konkretisht, përmes konsultimit të një sërë dokumentash dhe plane strategjike si për shembull, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, raportime të ndërlidhura të DG NEAR apo edhe konsultime me ekspertë të fushës,⁴ studimi ka për synim përfundimtar hartimin e një udhëzuesi praktik në shërbim të njësisive të qeverisjes vendore. Fokusi i udhëzuesit do të jetë zbulimi i mundësive të ndryshme të mbështetjes së pushtetit vendor, trajnimi për aplikimin, përthithjen dhe menaxhimin me efikasitet të tyre.

Qëllimi, mekanizmat dhe arsyet

Zhvillimi i një politike të brendshme të qëndrueshme, në nivel vendor dhe konkretisht pavarësia de facto e bashkive ndaj pushtetit qendror për aplikim për fonde në Bashkimin Evropian, do të mund të arrihet falë projektit tonë, i cili synon që t'i japë më shumë mundësi Shqipërisë në procesin e integritit në

³ "Albania 2015 Report," European Commission, 10 November 2015,

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf

⁴ Konsultim me ish-Ministren e Integritit Evropian, aktualisht Kryetare e Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian dhe Kryetare e Komisionit Parlamentar të Integritit, Znj. Majlinda Bregu.

BE, pikërisht falë fuqizimit të qeverisjes vendore, si një aktor me rëndësi të lartë dhe që luan rol kyç për arritjen e qeverisjes së mirë edhe sipas parimeve të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.⁵

Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet njësive të ndryshme territoriale, ndërmjet organeve të ndryshme të pushtetit vendor, falë binjakëzimeve ndërbashkiake, apo rajonale, është vetëm një ndër qëllimet e këtij projekti. Këto projekte të përbashkëta të bashkive ndërkufitare do të ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve vendorë për rëndësinë e rolit që ata kanë, si dhe të lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë në procesin e integritit të vendit, në mënyrë të veçantë pas hapjes së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Bashkëpunime të tilla do të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në shfaqjen e vullnetit politik nga bashki të drejtuara nga forca të ndryshme politike, por të njësuara tashmë nën një vizion të përbashkët gjatë realizimit të kapitujve për anëtarësim. Të qeverisurit mirë të njësive administrative-territoriale, nuk mund të jetë asgjë tjetër veç se një ndihmë për pushtetin qendror, duke ecur paralelisht në rrugën e gjatë të këtij procesi integruar.

Ndër të tjera, projekti synon të ndërtojë profilin e punonjësve që duhen angazhuar për të kryer këtë funksion koordinues në marrëdhënien organ vendor – institucion i BE-së, lehtësi që njësitë administrative-territoriale e gëzojnë për shkak të vetëpërcaktimit të organikave. Ndonëse gëzojnë këtë kompetencë, ngritja e kapaciteteve në bashki mbetet shqetësim sezioz, sidomos në zonat e largëta të cilat nuk kanë qenë në gjendje të tërheqin punonjës të kualifikuar.⁶ Kryerja e identifikimit të personave kyç do të mund t'u ofrohet me anë të kriterëve, metodologjisë dhe mënyrave të përcaktuara në një manual udhëzues, në mënyrë që ato vetë të mund të skanojnë dhe maksimizojnë kapacitetet e tyre njerëzore ekzistuese. Nxitja e ndërveprimit midis organeve vendore, organizatave të shoqërisë civile, grupeve aktive jo

⁵ Shqipëria e ka ratifikuar Konventën me Ligj. Nr.8548, datë 11.11.1999.

⁶ Ministri për Ceshtjet Vendore, Reforma Administrative-Territoriale; Analize e Situates se Qeverisjes Vendore ne Shqiperi, Prill 2014.

formale, ekspertëve, mediave lokale dhe aktorëve të tjerë të interesuar në këtë proces, do të vijë si rezultat i një studimi të mirë të impaktit të projekteve në komunitet, duke i dhënë përparësi atyre të cilët do të plotësonin nevojat më urgjente. Si rrjedhojë, do të kishim përmirësim të cilësisë së jetës, edhe falë nxitjes së komunikimit publik dhe transparencës me aktorët e interesuar ndaj projekteve të fituara dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Aktualisht, ndodhemi në një situatë ku, në dallim nga pushteti qendror i cili tashme ka struktura të posaçme në kuadër të lehtësimit dhe ndihmës në procesin e integritit, duke ngritur rrjetin e njësive të integritit evropian pranë çdo ministrie të linjës,⁷ për sa i përket situatës në bashkitë e vendit, vetëm 35 nga 61 të tilla kanë në përbërje të strukturës së tyre drejtori apo sektorë të projekteve me donatorët apo një zyrë koordinimi për integritimin e Shqipërisë në BE.⁸ Shpeshherë, kjo detyrë i është ngarkuar si vazhdim i përshtimit të punës, drejtorive apo sektorëve të ndryshëm në bashki apo edhe institucioneve qendrore, të cilat kryejnë aplikimin për fonde në emër të njësisë vendore. Kjo varësi do të mund të zvogëlohet, e më vonë të zhduket, vetëm falë përfshirjes së drejtpërdrejtë të vetë bashkive në procesin e aplikimit për fonde. Vënia në dispozicion e një manuali udhëzimesh, procedurash e politikash, i cili do të ketë si bazë informacionin e analizuar nga praktikat më të mira të Evropës Perëndimore dhe të vendeve të tjera të rajonit gjatë procesit të integritit të tyre në BE (para dhe pas hapjes së negociatave), nën mbështetjen edhe të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, e të Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale, do të jetë çelësi i suksesit të aplikimit për fonde të një njësie administrative-territoriale.

⁷ Fletore Zyrtare Nr. 116, 6 Korrik 2015; VKM Nr.577, date 24.6.2015 “Për ngritjen e rrjetit të njësive të integritit evropian dhe rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit në ministritë e linjës”;

⁸ Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale

Përfitime dhe ndikim

Nga analiza e mësipërme e gjendjes, shohim se është me rëndësi ndërhyrja në këtë pikë për shkak edhe të përfitimeve të drejtpërdrejta që vijnë nga ndërmarrja e këtij projekti.

- Përfitimi i parë dhe më i drejtëpërdrejtë është aftësimi i administratës së zyrave që punojnë me projekte sa i përket mënyrës, procedurës, identifikimit të mundësive për të aplikuar fonde drejtpërdrejt tek Bashkimi Europian dhe kjo është e arritshme në vlerën njëqind për qind në të gjitha bashkitë që kanë zyrë të marrëdhënieve me BE, apo zyrë të projekteve.
- Ky projekti synon rritjen e pavarësisë ekonomike të vetë Bashkive ndaj pushtetit qendror sa i përket realizimit të investimeve nga burime të tjera financiare jashtë buxhetit të shtetit, në këtë rast nëpërmjet projekteve të fituara drejtpërdrejtë nga Bashkimi Europian, shtetet anëtare të tij përmes marrëveshjeve dypalëshe apo edhe nga programe ndërkombëtare të mbështetjes së pushtetit vendor. Pavarësia ekonomike/financiare çon edhe në forcimin e rolit politik të Bashkisë si institucion i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët.
- Aftësimi i stafit rrit nga ana tjetër konkurrueshmërinë mes bashkive të vendit por edhe atyre të rajonit që nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të fitojnë në aplikimin e projekteve të rëndësishme/ cilësore dhe me përfitime të mëdha për komunitetin.
- Stafet e Bashkive tashmë të informuara nëpërmjet manualit mbi mundësitë e financimeve të BE, rrisin nivelin e bashkëpunimit me bashki të tjera brenda qarkut, apo edhe ato kufitare të shteteve fqinje për aplikimin e projekteve të përbashkëta, duke siguruar jo vetëm investime në vlera të vogla por edhe projekte strategjike dhe me vlera të mëdha për komunitetin.

- Bashki të ndryshme vendosin prioritete të ndryshme në strategjitë e tyre të zhvillimit të përbashkët. Aftësimi i stafeve e bën më të lehtë gjetjen e financimeve nga BE të projekteve prioritare të cilat janë të bazuara në vlerësimin e nevojave të përbashkëta të komunitetit. Pra, rriten kapacitetet e secilës bashki për realizimin e projekteve të kordinuara ngushtë me nevojat më imediate të komuniteteve të tyre.
- Ndonëse jo me përfitime të drejtpërdrejta financiare individuale, rritja e mundësisë së institucionit vendor për thithjen e fondeve të huaja, rrit cilësinë dhe standartin e jetës në komunitet dhe nivelin e infrastrukturës.
- Të gjitha këto përkthehen në cilësi, eficientë dhe mundësi më të mira zhvillimi social-ekonomik të zonës.
- Së fundmi, do të rritet ndërgjegjësimi tek aktorët vendorë për rëndësinë e rolit dhe lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me procesin e integritit të vendit, sidomos pas çeljes së negociatave;

Aneksë:

1. Organigrama e bashkisë Ura Vajgurore
2. Organigrama e bashkisë Dibër
3. Modeli i pyetësorit i përdorur në Urën Vajgurore dhe Dibër

Burimet studimore në të cilat jemi mbështetur janë:

- “Approved Draft Law "On Local Self-Government,”” Reforma Administrative Territoriale, 17 December 2015,
<http://www.reformaterritoriale.al/en/home/12-news-information/265-approved-draft-law-on-local-self-government>
- Lamallari, B., Freedom House, Nations in Transit 2016: Albania, fq.8
https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2016%20Albania_1.pdf
- “Albania 2015 Report,” European Commission, 10 November 2015,
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf
- Konsultim me ish-Ministren e Integritimit Evropian, aktualisht Kryetare e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian dhe Kyetare e Komisionit Parlamentar të Integritimit, Znj. Majlinda Bregu.
- Shqipëria e ka ratifikuar Konventën me Ligj. Nr.8548, datë 11.11.1999.
- Ministri për Ceshtjet Vendore, Reforma Administrative-Territoriale; Analize e Situtates se Qeverisjes Vendore ne Shqiperi, Prill 2014.
- Fletore Zyrtare Nr. 116, 6 Korrik 2015; VKM Nr.577, date 24.6.2015 “Për ngritjen e rrjetit të njësive të integritimit evropian dhe rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit në ministritë e linjës”;
- Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale
- Interviste në Bashkinë Dibër, përfshirë edhe Kryetarin e sapo zgjedhur. Gjendet në fund të materialit së bashku me personelin e bashkisë.
- Intervistë në Bashkinë Ura Vajgurore, me Kryetaren e Bashkisë. Gjendet në fund të materialit së bashku me organigramën e bashkisë.
- Gjithashtu një burim i mirë informacioni kanë qenë materialet e workshop-eve si pjesë e programit të Shkollës Politike.